

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-22-10260-211**

Sa i përket tenderit për **Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K.  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bregu i Diellit, Qendra Tregtare, nr. 42.,  
(Adresa)

Prishtinë  
(Vendi)

10000  
(Kodi postar)

044 999 007  
(Numri Telefonit)

N/A  
(Numri i Faks-it)

Ismail Baftijari  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com  
(Adresa elektronike)

06.01.2023  
(Data e parashtrimit të ankesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 27.09.2022

Dosja e tenderit – 27.09.2022

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara – 28.09.2022

Dosja e tenderit e korrigjuar – 08.10.2022

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 08.11.2022

B58 - Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 28.12.2022

Kërkesa për Rishqyrtim – 29.12.2022

Vendimi nga AK për Kërkesën për Rishqyrtim – 30.12.2022

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., më 29.12.2022 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në Komunën e Prishtinës, duke prezantuar argumentet ligjore që si Operator Ekonomik pjesëmarrës nuk jemi pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, për eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., nën arsyetimin se menaxheri i propozuar nga ne nuk është inxhinier i arkitekturës.

Në Kërkesën për Rishqyrtim INSI ka ofruar argumente ligjore që mbështesin konstatimet

tona se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., dhe se ne si OE ofertues jemi të përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kriteret e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues si në dosje të tenderit.

Megjithatë, në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ofron ndonjë kundër argument ligjor në argumentet tona ligjore dhe padrejtësisht refuzon kërkesën e parashtruar.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., parashtron Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**

**Neni 7 i LPP-së**

**Neni 59 i LPP-së**

**Neni 60 i LPP-së**

**Neni 62 i LPP-së**

**Neni 69 i LPP-së**

**Neni 40.6 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**

**Neni 40.12 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**

**Neni 43 i Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, më datë 28.12.2022 nëpërmjet sistemit elektronik E-prokurimi, ka publikuar B58 – Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për prokurimin e **Master plani për rigjenerim të lagjes Kolovica**, ku INSI-n e ka eliminuar nën arsyetimin se Menaxheri i propozuar nga ne nuk është inxhinier i arkitekturës, dhe e ka anuluar në tërësi këtë aktivitet të prokurimit. (**bashkëngjitur Vendimi i AK, i publikuar në sistemin elektronik E-prokurimi**).

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., pas publikimit të Vendimit të AK ka përgatitur dhe dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.

INSI pas analizimit të tërësishëm të dokumenteve relevante dhe arsyes së AK-së për

eliminimin tonë si OE, konsideron se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me vendimin për eliminim të OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., përkatësisht anulimin në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar tenderin tonë duke cituar si vijon:

“Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

**Menaxher të projektit e keni caktuar personin me profesion urbanist e jo inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj.”**

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., konsideron se vendimi i AK për eliminimin tonë si OE ofertues është i paqëndrueshëm për faktin se Inxhinieri i propozuar si menaxher është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht menaxheri i propozuar nga ana e INSI-t, z. Flamur Kuçi, i plotëson të gjitha kërkesat si në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, i cili ka edhe përvojë të gjatë dhe të dëshmuar në fushën përkatëse.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës në dosjen e tenderit për stafin profesional, përkatësisht menaxheri i projektit ka theksuar se duhet të jetë Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës.

**Dëshmi: Kërkesa e AK për menaxherin**

2.OE-ik duhet te ofroj deshmi per stafin profesional dhe ate si vijon:

- Menaxheri i projektit -  
Inxhinier i ndërtimtarisë ose  
arkitektures, minimum 5 vite  
përvojë pune,



Sipas kësaj kërkesë, kuptohet qartë se AK nuk ka specifikuar ndonjë drejtim të caktuar që duhet të ketë menaxheri i projektit.

Andaj, inxhinieri të cilin INSI e ka propozuar si Menaxher të Projektit, z. Flamur Kuçi, i përmbushë të gjitha kërkesat plotësisht si në dosje të tenderit.

**Dëshmi: Diploma e studimeve themelore të z. Flamur Kuçi:**




Nr. 3030

*Diplomë*

Nr. 3030

Studenti FLAMUR RASIM KUÇI

filloistudimet në vitin 1992

dhe mbaroi në vitin 1998

kursin e plotë të Fakultetit INXHINIERISE  
SE NDERTIMIT

*Te Universitetit Politeknik Tiranë*

në degën ARKITEKTURE

Me vendim të komisionit shtetëror

dt 18 Shkurt 1999

I jepet titulli URBANIST

REKTORI I UNIVERSITETIT  
DR. TAMARA EFTIMI

Dekani i Fakultetit AS. PROF. NIKO LAIKO

Kryetari i komisionit shtetëror DR. TAMARA EFTIMI

Tiranë më 6.04.1999 Nr. i regjistrimit 2512

Bazuar në diplomën e studimeve themelore të z. Flamur Kuçi, qartë mund të kuptohet se i njëjti është Inxhinier i Arkitekturës, me studime 5 vjeçare të përfunduara në Universitetin Politeknik në Tiranë, që nënkupton se e plotëson kushtin e paraqitur nga AK.

Në sistemin publik të arsimit në Shqipëri, Urbanist nënkupton specializim të thelluar të profesionit të Arkitetit. Pra, nënkupton se nuk mund të jesh Urbanist nëse nuk je arkitekt. Kjo është vërtetuar edhe nga diploma, e që nënkupton se konkluzioni i nxjerr nga AK është thellësisht i gabuar.

Për më shumë, si dëshmi e gjeni të bashkëngjitur edhe një vërtetim nga Universiteti Politeknik i Tiranës, lëshuar për z. Flamur Kuçi, i cili dëshmon se të njëjtit i njihet titulli Arkitekt dhe që studimet e tij janë të barasvlershme me titullin Master në Arkitekturë.

**Dëshmi: Vërtetimi i Universitetit Politeknik të Tiranës për z. Flamur Kuçi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**ZV/DEKANI**

Nr. 547 Prot

Data 23.12.2022.

**VËRTETIM**

Vërtetohet se Z. Flamur Kuçi ka përfunduar programin 5-vjeçar pranë, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, profili Urbanist.

Ka filluar studimet në vitin 1992 dhe i ka përfunduar në vitin 1998.

Nr. i Diplomës 3030 Nr. Regjistri 2512

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, kreu XIII, dispozita kalimtare dhe të fundit Neni 124, pika 2 diploma e integruar e nivelit të dytë e Z. Flamur Kuçi është ekuivalente me diplomë "Master i Shkencave", 300 (treqind) kredite. Programi 5-vjeçar, Titulli Arkitekt dhe Urbanist që fakulteti ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Arkitekturë", profili Arkitekt dhe Urbanist. Këto studime përfshijnë një sërë instrumentesh teorike në programin e studimit për të mundësuar tek studentët marrjen e bazave të nevojshme shkencore, aftësi metodike kërkimore dhe kualifikimin profesional në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës. Programi i studimit, në profilin urbanist, ka si objekt kryesor formimin e profesionistëve të aftë të integrohen në tregun e punës, duke shfaqur njohuri të plota në ballafaqimin me projektet arkitektonike, ndërhyrjet urbane dhe zhvillimet territoriale. Programi mësimor është organizuar në mënyrë të tillë të gërshetojë sa më mirë njohuri specifike për një formim sa më të plotë për një profesion ndërdisiplinor, siç është figura e arkitektit / urbanistit. Formimi në Master Shkencor, për profilin urbanist, përmbyllet me një veprimtari të rëndësishme shkencore, me një punim diplome, e cila vë në provë njohuritë e grumbulluara dhe aftësitë sintetizuese, kreative dhe të komunikimit të kandidatit, në shërbim të ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane. Mbajtësi i kësaj diplome, Master i Shkencave, mund të punësohet si projektues arkitekt dhe urbanist (profesion i rregulluar) në ndërmarrje / organizata publike apo private. Kjo diploma mundëson marrjen e Licencës profesionale, pa detyrim të kurseve të mëtejshme akademike, duke ndjekur specifikimet në legjislacionin përkatës, bazuar në vite dhe eksperiencë pune.

I lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së tij/saj.

**ZV.DEKANI**



Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", 54, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2229045, web: www.fatn

Po ashtu, duke e pas parasysh natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit Studim i Fizibilitetit i Master planit për rigjenerim të një zone urbane siç është Kolovica, e për më shumë që z. Flamur Kuçi ka titull Master dhe Doktor Shkence në Fakultetin e Arkitekturës, përvoja shumë vjeçare e punës, z. Flamur Kuçin e bënë edhe më të kualifikuar për këtë pozitë për të cilën INSI e ka propozuar.

**Dëshmi: Diplomat e studimeve Master dhe Doktoraturë**

The International Committee of Examiners herewith declares, that

**Flamur Kuci**

Place of birth: Shkodra, Albania


Date: 25 November, 1973

has successfully completed the international Master of Arts programme in Urban Management which was held between 3 September, 2003 - 22 September, 2004 and therefore has been granted the degree of:

## **MASTER OF ARTS IN URBAN MANAGEMENT**

with all the rights and honours pertaining thereto in testimony whereof this diploma is granted.

Rotterdam, 22 September, 2004



Prof. Dr. W.H.A. Hofman  
Director  
Institute for Housing and  
Urban Development Studies



Prof. Dr. L. van den Berg  
Scientific Director  
Urban Management Centre  
Erasmus University Rotterdam

The Ministry of Education, Culture and Science of the Kingdom of the Netherlands endorses the academic standard of the degree awarded by this diploma as this programme complies with the standards imposed by the Netherlands Higher Education quality control system.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË**  
**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

Nr. i regjistrimit shtetëror **2885**

Mbështetur në Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 864 datë 05.12.2007, VKM Nr. 877 datë 18.06.2008 e duke patur parasysh:  
Diplomën Universitare, Diplomën e Studimeve të Thelluara Pasuniversitare si dhe temën e disertacionit me titull: **“Ndikimi i rregjimit të pronësisë në modelin e zhvillimit të tokës; Si ndikon fragmentarizimi i pronës në zhvillimin urban”**, mbrojtur në datë 30.01.2017 para Jurisë së përbërë nga: Akademik Jorgaq KAÇANI - Kryetar dhe Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA, Prof. Asoc. Armand VOKSHI, Prof. Dr. Agron LUFI, Prof. Dr. Artan FUGA - Anëtarë

I Jepet

**Z. Flamur Rasim KUÇI**, lindur më 25.11.1973

Grada shkencore

**Doktor**

Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës  
Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA

Numri i matriculimit **POINDN 000312**

Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës  
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

Tiranë, më 10.11.2017  
Nr. i regjistrimit **339**

Përveç tjerash, menaxheri i propozuar nga Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., z. Flamur Kuçi është edhe i licencuar në projektim arkitektonik dhe urbanistik, që e bënë edhe më shumë të kualifikuar për pozitën e propozuar në këtë projekt, e për më shumë nëse kualifikimi “Urbanist” nuk do të përfshinte të qenurit Arkitekt, shteti shqiptar nuk do e licensonte z. Flamur Kuçi për projektim Arkitektonik dhe Urbanistik. Madje në mënyrë që të licensohesh aplikantit i duhet që të provojë eksperiencat e tija në projektim arkitektonik. Andaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se z. Flamur Kuçi është urbanist e jo arkitekt, është i paqëndrueshëm dhe demantohet lehtë nga Licensa profesionale e z. Flamur Kuçi.

**Dëshmi: Licenca**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mblikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

**L I C E N C Ë**  
**A.1660/1**

MBIEMRI	KUÇI
EMRI	FLAMUR
ATËSIA	RASIM
DATËLINDJA	25.11.1973, Shkodër
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLOMUAR, MË	1999
TITULLI	Urbanist
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	24.07.2017



**NË PROJEKTIM**

Kat.	1	c	Plane të detajuara vendore.
Kat.	2	a	Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike.
		b	Projektim: 1. Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. Qendra tregtare, objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. Objekte spitalore, terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.
		c	Projektim interiere.
		d	Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**GERTA LUBONJA**





Për ta sqaruar edhe më shumë këtë çështje, kemi parashtruar kërkesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Qendrën Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik, për titullin akademik të z. Flamur Kuçi.

Sipas Qendrës Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik të

MASHTI-të, sa i përket diplomës së studimeve themelore të z. Flamur Kuçi, ka theksuar se titulli Arkitekt dhe Urbanist që Fakulteti ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt dhe Urbanist, që nënkupton se edhe NARIC Kosova titullin e fituar në studimet themelore të z. Flamur Kuçi e njeh si ekuivalent me ciklin e dytë Master të Shkencave në Arkitekturë.

Dëshmi: Përgjigje nga NARIC Kosova



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik NARIC

DATE/A:	30.12.2022
REFERENC-E:	2/6 5274
PËR/ZA/TO:	Avokat Labinot Vata, përfaqësues i autorizuar i z. Flamur Kuçi
NGA/OD/FROM:	Kumrije Gagic, Udhëheqëse në Qendrën Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik NARIC - KOSOVA
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje

I nderuar Avokat Vata,

Lidhur me kërkesën tuaj, ju njoftojmë për sa vijon:

Qendra Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik, merret me njohjen/ barasvlerën e diplomave të shkollave të Larta Profesionale dhe Gradave Universitare dhe gjithashtu bën Informimin Akademik, sipas kërkesave të grupeve të interesit.

Deri më tani, grada të ngjashme të fituara në Universitetin Politeknik të Tiranës, janë njohur ashtu siç janë fituar në Universitetin përkatës. Sipas dokumentit të lëshuar nga Universiteti, si autoritet përgjegjës për dhënien e gradës së nivelit të 7 (master), theksohet se titulli Arkitekt dhe Urbanist që Fakulteti ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, Profili Arkitekt dhe Urbanist. Si e tillë, kjo gradë pranohet edhe nga NARIC Kosova.

NARIC e jep këtë sqarim në kuadër të komponentës së Informimit Akademik.

Me respekt,

Edhe përgjigja e NARIC Kosova sa i përket titullit akademik të z. Flamur Kuçi, sqaron mjaftushëm këtë çështje dhe jep të kuptohet se INSI i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues si në dosje të tenderit, dhe se AK ka bërë shkelje të dispozitave

ligjore kur ka eliminuar OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., nga ky aktivitet i prokurimit, përkatësisht duke anuluar në tërësi aktivitetin.

Për më shumë, duke pas parasysh se për menaxher të projektit nuk është specifikuar drejtimi i caktuar, INSI konsideron se nuk mundet as të eliminohet mbi bazën e një kërkesë që nuk është kërkuar specifikisht në dosje të tenderit, e për më shumë që menaxheri i projektit i propozuar nga INSI e plotëson kërkesën e paraqitur nga AK, pasi që i njëjti është Inxhinier i Arkitekturës.

Shih: **Rregullore nr. 1/2022 për Prokurim Publik:**

***40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.***

Vlen të theksohet se ne si OE ofertues ju kemi përmbajtur në tërësi kërkesave specifike të Autoritetit Kontraktues, dhe për analogji kemi kërkesën për Master të shkencave shoqërore të Biologjisë – drejtimi i ambientit, e cila është kërkuar në këtë dosje të tenderit.

**-Master i shkencave shoqërore  
Biologji-drejtimi i ambientit  
,minimum 3 vite përvje pune,**

Në këtë rast ne i jemi përmbajtur në tërësi kërkesave të Autoritetit Kontraktues duke propozuar për këtë pozitë ekspertin që ka drejtimin e ambientit, me qëllim të plotësimit të kërkesës në tërësi.

Duke u bazuar në faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

**INSI është i bindur sa ka dorëzuar tender të përgjegjshëm sepse tenderi ynë i përmbush të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues, është në pajtim me LPP dhe e përmbush në tërësi Nenin 40.6 të Rregullores nr. 1/2022 për Prokurim Publik:**

**40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:**

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;***
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;***
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.***

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi i vetmi OE që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të merr këtë:

#### **VENDIM**

- 1. APROVOHET si e bazuar** Ankesa e paraqitur nga Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K.
- 2. ANULOHEt** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit

dhe lënda të kthehet në

**RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe dispozitave të LPP-së.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, kërkesën për rishqyrtim, ankesën dhe fitim të munguar në vlerë prej 80.000.00 Euro.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



## NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ PUNË☐ FURNIZIM☒ SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 26.09.2022

Nr i Prokurimit	616-22-10260-2-1-1
Nr i brendshëm	616 22 130 211

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

## I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES		
Adresa Postare: TREPQES NR.2		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Nexhmi Mekolli		Telefoni: 038 230 900
Email: prokurimi.prishtine@rks-gov.net		Faksi: n/a
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kk.rks-gov.net/prishtine/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

**Nëse po**, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS



## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**  
**Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**  
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

<input type="checkbox"/> <b>Punë</b>	<input type="checkbox"/> <b>Furnizime</b>	<input checked="" type="checkbox"/> <b>Shërbime</b>
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit  
**Lagjja Kolovica**

### II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë  
☐

### II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator  
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator  
☐

#### Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi  
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë  
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**  
**Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

93000000-8

**II.1.7) Variantet pranohen**

Po ☐ Jo ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

Po ☐ Jo ☒

*Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)**

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

**Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 400 000,00**

**II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS**

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)**  
**Referoju përshkrimit të cmimit**

**II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM**

Kohëzgjatja në muaj **6** apo ditë (nga dhënia e kontratës)  
apo  
Fillimi  
Përfundimi

**NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**

**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN**

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

Po ☒ Jo ☐

*Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10 % % e vlerës së kontratës*

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):**

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

Po ☐ Jo ☒

*Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta*

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

<p><b>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</b></p> <p>1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <a href="http://krpp.rksgov.net">http://krpp.rksgov.net</a></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësor te lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.</p>
<p><b>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</b></p> <p>1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Kopja e Certifikatës se biznesit</p>
<p><b>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b></p> <p>n a</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>n a</p>
<p><b>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</b></p> <p>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere minimale 500,000 euro ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate .</p> <p>2.OE-ik duhet te ofroj deshmi per stafin profesional dhe ate si vijon; - Menaxheri i projektit -Inxhinier i ndërtimtarise ose</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve.</p> <p>2.CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.</p>

arkitektures, minimum 5 vite përvojë pune, - Inxhinier i arkitektures minimum 3 vite përvojë pune, Konsulent Ekspert Socio Ekonomik për banim, - Master i juridikut minimum 3 vite përvojë pune, keshilltar ligjor konsulent i planifikimit, - Master i arkitektures minimum 3 vite përvojë pune, planifikuesi -Inxhinier ose master i ndertimtarise minimum 3 vite përvojë pune, rruget dhe infrastruktura, -Inxhinier i komunikacionit minimum 3 vite përvojë pune, -Master i shkencave shoqerore Biologji-drejtimi i ambientit minimum 3 vite përvojë pune, konsulent i qendrushmerise, -Master i ekonomise minimum 3 vite përvojë pune, konsulent i kosotos.	
--	--

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> <b>III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</b>  Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse
<b>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

<b>IV.1.1) Lloji i procedurës</b>
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur
<input type="checkbox"/> E kufizuar
<input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata
<input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit
<b>IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim</b> (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)  Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:
<b>IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave</b> (procedurë konkurruese me negociata)  Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar  Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë

kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata	
Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
<b>IV.1.4 Numri minimal i kandidatëve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:</b>	
<b>IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik</b>	
Do të përdoret ankandi elektronik:	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:	

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

<input checked="" type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët
<input type="checkbox"/>	Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të
<input type="text"/>	

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

<b>IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë</b>	
Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, Njoftim paraprak: i	
Publikime tjera (nëse aplikohen): i i	
Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Dokumentet me pages	
Nëse po, çmimi EUR Kushtet dhe metoda e pagesës:	
<b>IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:</b>	
data <b>08.11.2022</b> koha <b>13:30:00</b> vendi <b>Komuna e Prishtines, Departamenti i Prokurimit , permes platformes elektronike te E-prokurimit.</b>	
<b>IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:</b>	
<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
Nëse po, jep arsyetim	
<b>IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:</b>	
Po <input checked="" type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit <b>6000</b> Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë <b>120</b> apo muaj	



**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**

Deri më: data:        ditët **90** apo        muajt

**IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**

data **08.11.2022**    koha **13:30:00** vendi **Komuna e Prishtines, Departamenti i Prokurimit , permes platformes elektronike te E-prokurimit.**

**NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE****V.1) ANKESAT**

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.**

**V.2) INFORMACIONET SHITESË**

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**

*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)*

**PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA**

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	616-22-10260-2-1-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	616 22 130 211		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbyljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
08.11.2022	08.11.2022, 13:30:00	08.11.2022, 13:30:00	Komuna e Prishtines, Departamenti i Prokurimit , permes platformes elektronike te E-prokurimit.	4

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndrysimi/plotësimi Supplement /Amendment Dpuna/Izmjena
1.	Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K. BREGU I DIELLIT - QENDRA TREGTARE LOK.NR.42, 10000, PRISHTINË	1108	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica	PO	171186.44	202000.00	JO
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik URBAN PLUS; Architecture for Humans L.L.C.Rr. UCK 178/1-1, 10000, Prishtina	1111	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica	PO	205000.00	250000.00	JO
3.	" GM Architecture " SH.P.K. Rr. Isa Kasstrati Obj.49-K4 Nr. 41, 10000, Prishine	MPK22	Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica	PO	81567.80	96250.00	JO
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Ardnovatic	1000	Master plani per rigjenerimin e	PO	180000.00	212400.00	JO

	<b>SHPK Branch in Kosovo; N.P.SH. Hidroprojekti ; ENI Design SH.P.K. rr.Xhevded Doda Dukagjini Residence Hyria A 78A, 10000, Prishtine</b>		<b>Iagjes Kolovica</b>					
--	--	--	------------------------	--	--	--	--	--

[Ne rast se kriteri i shpërblini të kontratës është Çmimi me i ulët] [If the contract award criterion is the lowest price] [Ako je kriterijum za dodelu ugovora Najniža cena]

[ÇMIMET PER NJESI, kurdo që është e mundur varësisht prej numrit të tenderëve të dorëzuar, pozicioneve/artikujve, dhe pjesëve/lotëve. Kjo të vendoset nga AK]

[The unit prices, whenever possible depending on the number of tenders submitted, items / articles, and parts / lots. The CA decides]

[CENE PO JEDINICI, uvek, kada je moguće u zavisnosti od broja podnetih tendera, pozicija/artikala, i delova/lotova. Ovo će odlučiti UA]

Tenderuesi Tenderer Ponudač	Pjesa Lot Deo	[Çmimi për Njësi] [Unit Price] [Cena po jedinici]									
		Art. 1	Art. 2	Art. 3	Art. 4	Art. 5	Art. 6	Art. n	Art. n+1		
1	1										
	2										
	n										
2	1										
	2										
	n										
3	1										
	2										
	n										

[Sho ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet Tenderi ekonomikisht me i favorshëm]

[Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if most economically advantageous tender]

[Dodaj ili izbrisi redove po potrebi u ovoj tabeli. Izbrisi celu tabelu ako se primenjuje ekonomski najpovoljniji tender]

[Në rast se kriteri i shpërbëimit të kontratës është Tenderi ekonomikisht me i favorshëm] [If the contract award criterion is most economically advantageous tender] [Ako je kriterij dodelu ugovora Ekonomski najpovoljniji tender]

Tenderuesi Tenderer Ponudač	Pjesa Lot Deo	Afati i liferimit në ditë Delivery time Datum isporuke	Garancioni Guarantee Garancija	Etj Etc Itd.	Etj Etc Itd.	Etj Etc Itd.
1	1					
	2					
	3					
2	1					
	2					
	3					
3	1					
	2					
	3					

[shtu ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet tenderi me çmimin me të ulët]  
 [Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if lowest price tender]  
 [dodaj ili izbriši po potrebi u ovoj tabeli. Izbriši celu tabelu ako se primenjuje tender sa najnižom cenom]


**Komente nga përfaqësuesit e pranishëm**  
**Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:**  
**Komentari prisutnih ovlašćenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda**



**Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO**

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënskrimi Signature Potpis

**Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja**

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënskrimi/ Signature/ Potpis	Date/ Date/ Datum
Shqipe Isufi		
Shehida Jashari		08.11.2022
Elanur Sallahu		08.11.2022
Fatinda Bajrami		

**Nënskrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:**

Shqipe Isufi

  
 \* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

PRISHTINA



KOMUNA E PRISHTINË \* MUNICIPALITY OF PRISHTINA \* SHKUPÇINA E PRISHTINË \* PRISTINA

## NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica"**

Nr i Prokurimit	616-22-10260-211
Nr i brendshëm	616 22 130 211

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertes
1.	Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K., BREGU I DIELLIT - QENDRA TREGTARE LOK.NR.42, 10000, PRISHTINË	202000.00
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik URBAN PLUS; Architecture for Humans L.L.C, Rr. UCK 178/1- 1, 10000, Prishtina	250000.00
3	" GM Architecture " SH.P.K., Rr. Isa Kastrati Obj.49-K4 Nr. 41, 10000, Prishtine	96250.00
4	Grup i Operatorëve Ekonomik Ardnovatic SHPK Branch in Kosovo; N.P.SH. Hidroprojekti ; ENI Design SH.P.K., rr.Xhevded Doda Dukagjini Residence Hyrja A 78A, 10000, Prishtine	212400.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit: **Komuna e Prishtinës vendos që të anulohet kete aktivitet për arsye se të katër OE-ik janë të papërgjegjshëm .**

Emri dhe mbiemri i ZPP: Nexhmi Mekolli

Data: 28-12-2022

## Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar <sup>1</sup>

Komuna e Prishtines

Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K.- PRISHTINË

Nr i Prokurimit	616-22-10260-211
Nr i brendshëm	616 22 130 211

Titulli: "Master plani per rigjenerimin e lagjes Kolovica"

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

[Tenderi juaj] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është administrativisht i papërgjegjshëm:

Nuk keni dorëzuar sigurimin e tenderit.

☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit]

Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;

Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;

☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;

